



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Forca e lutjes

8 Shkurt 2015



Në atë kohë, Jezusi posa doli nga sinagoga, shkoi me Jakobin e me Gjonin në shtëpinë e Simonit e të Andreut. Vjehrra e Simonit ishte në shtrat ndër ethe. Menjëherë i treguan për të. Jezusi u afrua, e kapi për dore dhe e ngriti. E lëshuan ethet dhe u shërbeu. Në mbrëmje, me të perënduar të diellit, ia sollën para të gjithë të sëmurit dhe të djallësorit. Mbarë qyteti u mbledh para derës. Ai i shëroi të sëmurët – ishin shumë dhe me sëmundje të ndryshme. Dëboi edhe shumë djaj. Por nuk i lejoi djajtë të flasin sepse e njihnin. Herët në mëngjes, kur ende ishte natë, Jezusi u çua e shkoi në një vend të pabanuar e atje thoshte uratë. Simoni me shokët e vet u vunë ta kërkojnë. Kur e gjetën i thanë: “Të gjithë po të kërkojnë.” Ai u tha: “Ejani të shkojmë gjetiu, në fshatrat e afërme, që të predikoj edhe atje. Prandaj edhe erdha.” Dhe i ra kryq e tërthor Galileesë duke predikuar nëpër sinagogët e tyre dhe duke dëbuar djajtë.

Mk 1, 29-39

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

9 Shkurt	Shen Apollonia
10 Shkurt	Shen Skolastika
11 Shkurt	Zoja e Lurdit
12 Shkurt	Shen Aleksi
14 Shkurt	Shen Cirili dhe Metodi

Keshilli i ri i Kishes...

Pas terheqies nga lista fillestare per ne Keshill e Nush Kacaj, Aleksander Selmani dhe Luk Gjollaj; Keshilli i ri perbehet nga keta anetare:

1. Aleksander Koka
2. Arben Toma
3. Gjovalin Selmani
4. Luigj Narkaj
5. Nik Biqi
6. Paulin Marku
7. Petrit Ujkaj
8. Prek Gjollaj – Kryetar i Këshillit
9. Sokol Sterbyqi
10. Vasel Dreshaj
11. Viktor Gjokaj
12. Vilson Prekaj

Te gjithëve u kerkojme ti luten Zotit qe keta anetare te cilet ju i keni votuar, dhe e kane pranuar detyren ne Keshill, te udhehiqen nga ndenja e sherbimit per te miren e perbashket.

Kursi i gjuhes shqipe...

Çdo te diele ne oren 11 te ambientet e Kishes ne Browns Line vazhdon kursi i gjuhes shqipe per femijet!

Hakun e Kishes per vitin 2014

e kane dhene:

Agron	Markaj
Aleks	Coku
Aleksander	Stolaj
Alfred	Shllaku
Altin	Miri
Angjelin	Kaçaj
Anton	Brunga
Anton	Malaj
Anton	Tinaj
Anton	Brunga
Arben	Marku
Arben	Toma
Arben	Pepa
Arben	Therqaj
Ardian	Preçetaj
Arjana	Nati
Astrit	Simeqi
Aurel	Vata
Beniamin	Hasko
David	Shtjefhilaj
Dod	Ndreu
Edmond	Kacorri
Eduard	Shkreli
Elvis	Bzhetaj
Erion	Tase
Fatmir	Qosaj
Federik	Gjergji
Flobenc	Shkalla
Gac	Gjoka
Gezim	Lanazi
Gjergj	Gjinaj
Gjergj	Nikolla
Gjon	Dreshaj
Gjovalin	Melaj
Gjovalin	Luli
Gjovalin	Selmani
Ilir	Shyti
Ilir	Daka
Ilir	Gjokaj
Ladi	Lumaj
Lek	Selmani
Lekë	Tarazhi
Lekë	Kapllaj
Leks	Dragu
Linda	Kalavaci

Ljuc	Juncaj
Luigj	Narkaj
Luk	Gjolaj
Luvigj	Lallinaj
Marash	Martinaj
Marin	Muzhani
Mario	Martini
Mark	Ndoci
Mark	Shkreli
Martin	Pjetri
Martin	Vuktilaj
Martin	Marashaj
Mhill	Ftoni
Ndok	Macaj
Ndue	Cacaj
Nik	Biçi
Nua	Selmani
Nush	Kacaj
Nush	Dokaj
Pal	Rransburgaj
Paulin	Lukani
Paulin	Marku
Petrit	Ujka
Petrit	Ujkaj
Pjerin	Kalaj
Pjeter	Preka
Pjeter	Tunaj
Pjeter & Bep	Dreshaj
Prek	Frani
Prek	Lekaj
Prek	Spaqi
Prek	Kaçaj
Preke	Gjonaj
Prel	Pepushaj
Roza	Kalaj
Rrok	Gjoni
Sander	Kosmaci
Sokol	Sokoli
Sokol	Sterbyci
Sokol	Ujka
Sokol	Gashaj
Tom	Ulaj
Tome	Ivanaj
Ton	Vocaj
Tonin	Kastrati
Valmir	Gjinaj
Vasel	Dreshaj
Vaso	Gjuravcaj

Viktor	Pleti
Viktor	Gjokaj
Vitor	Mernacaj
Vladimir	Doda
Zef	Deklaj
Zef	Lulaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Kontribut per Kishen tone... Kane dhene kontribut **Shpend Pellumaj \$500, Matteo Codispoti (Play Cafe) \$300.**

Ardian Ndreca: komunizmi edukoi një brez me ideale çnjerëzore e shkatërroi vlerat kombëtare



Kujtojmë 6 shkurtin e vitit të kobshëm 1967, kur Shqipëria u shpall i vetmi shtet ateist në botë. Nisi kështu etapa më tragjike e një populli të tërë, nxitur nga fjalimi famëkeq kundër zakoneve prapanike dhe paragjytimeve fetare, mbajtur nga diktatori komunist më 6 shkurt 1967, përmes të cilit u shkatërruan vlerat e vërteta të traditës shqiptare e u vendosen themelet e një ferri të vërtetë. **Me profesor Ardian Ndrecën, profesor i filozofisë e drejtor i Institutit të studimeve mbi ateizmin pranë Universitetit Papnor 'Urbaniana' në Romë,** po e kujtojmë këtë datë e këtë ngjarje të kobshme që përjetoi populli shqiptar, i cili në mikrofonin e Radio Vatikanit mes tjerash pohon se *"komunizmi edukoi një*

brez te tanë me ideale çnjerëzore, me mungesën e respektin për personin, me mungesën e respektin për lirinë e tjetrit, e fut një frymë që nuk ishte as fryma e as tradita kombëtare shqiptare dhe as tradita e humanizmit evropian”.

Në realitet mund të thuhet se, diktatori e komunizmi nuk e duronin dijen dhe besimin e njerëzve në Hyjin, madje kishin një frikë të tmerrshme nga intelijenca dhe forca shpirtërore e njerëzve e posaçërisht të atyre personaliteteve që ishin më të ngritur, më largpamës, më guximtar e më atdhedashës se ata. Udhë e mënyra e vetme për t’u liruar nga këta njerëz të ngritur, të ditur, të urtë, atdhetarë të vërtetë që përhapnin dritën e përparimit të vëllazërimit tek populli besimtar, ishte vrasja dhe persekutimi deri në internime e zhdukje fizike. 6 Shkurti i vitit 1967, na kujton pra ditën kur Enver Hoxha mbajti fjalimin me titull “Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe pushtetit”, fjalim ky me të cilin ai filloi luftën kundër “ideologjisë fetare” e “zakoneve prapanike”, duke e shpallur me ligj Shqipërinë kundër Zotit, si vendin e parë dhe të vetëm ateist në historinë botërore. Ky veprim i regjimit komunist të Enver Hoxhës do të ishte qesharak — siç përqeshej ky vendim në median botërore të kohës dhe më vonë — po të mos ishte për pasojat e rënda që ky vendim i regjimit komunist shqiptar pati mbi shoqërinë shqiptare atëherë, pasojat e të cilit ndihen ende sot. Megjithëse shtypjet kundër fesë kishin filluar ç’prej vitit 1945, sidomos kalvari i Kishës Katolike e udhëheqësve të saj kishte qenë tepër i egër gjatë dy dekadave pas ardhjes së komunistëve në fuqi. Megjithëse rrethanat e numri i të përndjekurve nga regjimi komunist, shumë prej tyre klerikë katolikë shqiptarë por edhe të dy feve të tjera, myslimanë dhe ortodoksë, u vranë ose vdiqën nën tortura të pamagjinueshme nëpër burgjet e kampet komuniste të regjimit hoxhist, nga viti 1945-1960. Numri i klerikëve të vranë ose të vdekur nëpër burgje e kampe përqendrimi-katolikë, myslimanë e ortodoksë — nën torturat më ç’njerëzore gjatë asaj periudhe, ndoshta nuk do të dihet kurrë. Kështu më 19 shkurt 1967 u ndalua kremtimi i Meshës Shenjte i orës 10 në Katedralen e Shkodrës. Françeskanët shkodranë morën urdhrin të zbraznin Kuvendin e Gjuhëdolit, duke mbartur

gjithë ç’kishin në Kuvendin e Arrës së Madhe. Pas një kontrolli të rreptë të sigurimit, u mbyll edhe Argjipeshkvia katolike. Njëkohësisht nisën mbledhjet komuniste nëpër lagje për demaskimin e klerit, ndër të cilat u dha sinjali i sulmit për mbylljen e të gjitha Kishave. Më 4 mars u mbyll Kisha katedrale e Shkodrës e mbas saj, njëri pas tjetrit, të gjithë tempujt e Zotit. E fundmja u mbyll Kisha e fshatit Delbinisht, ku fshatarët rezistuan derisa nisën arrestimet. Të Premten e Madhe të Pashkëve të vitit 1967 qeveria komuniste e Tiranës i ngarkoi mbi shpinë Kishës katolike shqiptare Kryqin e Krishtit. Nisi kështu ngjitja në Kalvar, deri në kryqëzim e deri në ringjallje, në të tretën ditë. E gjatë kësaj ngjitjeje të mundimshme, pati edhe meshtarë si Atë Pjetër Meshkalla, jezuit e intelektual shqiptar, që morën guximin ta shpallnin haptas të vërtetën mbi diktaturën komuniste, anti-shqiptare, anti-demokratike, duke u bërë shembull për qëndrimin që duhet të mbajë çdo shqiptar përballë mashtrimit e gënjeshtërsisë qeveritare në çdo kohë.



EAR JESUS,

help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.



Giovanni Selmani
Sales Representative
Direct:
647.500.3875

Office: 905.565.9200
Fax: 905.565.6677
E-Mail: gioselmani@hotmail.com
www.rightathomerealty.com

7045 Edwards Blvd., Suite 401
Mississauga, ON L5S 1X2

